



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4807 prot.

Vlorë, më 24.04 2023

PROJEKT -VENDIM

Nr. _____ , datë ____ . ____ . 2023

PËR

MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGJA E BANESËS TË Znj. ENJELLUSHE HALILI NË DATËN 23.01.2023, DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj.Engjëllushe Halili, e ndodhur në lagjen “Hajro Çakërrri”, Rajoni Nr 1 Bashkia Vlorë, në datën 23.01.2023 ,sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

- 146.891 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një) lekë për punime ndërtimi.
(293.783x50%)

● 110.772(njëqin e dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

Koncept: O.Bejto

Miratoi: A.Vreshtazi

KRYETARI

Dritan LELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4007 prot.

Vlorë, më 24.04 2023

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN PËR MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E ZNJ.ENGJELLUSHE HALILI NË DATËN 23.01.2023 DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë, në datën 23.01.2023 ka paraqitur kërkesën znj.Engjëllushe Halili me Nr.880 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "Hajro Çakërrri", Rajoni Nr.1 Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.12 datë 19.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Pasi u hartua proces-verbali i konstatimit të gjendjes në date 27.01.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.880/3 prot, date 30.03.2023 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të Znj.Engjëllushe Halili”, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.4719, datë 20.04.2023 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të Znj.Engjëllushe Halili në lagjen "Hajro Çakërrri" Vlorë, ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

1.Vlera e dëmeve në banesën e Znj. Engjëllushe Halili është 257.663(dyqind e pesëdhjet e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tre) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjen për banesën e djegur.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Znj.Engjëllushe Halili në datën 23.01.2023 sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile i Bashkisë Vlorë.

Drejtori i Mbrojtjes Civile

ADRIAN VRESHTAZI

